



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 106 Prot.

Tiranë, më 18.01.2023

V E N D I M

Nr. 07, Datë 18.01.2023

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën nr. 114, datë 03.08.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, në të cilën pretendohet për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara nga Bashkia Kamëz lidhur me garantimin e aksesueshmërisë dhe përshtatshmërisë në territorin e bashkisë dhe kryesisht në “Bulevardin Blu¹” (Nënë Tereza). Me vendimin nr. 197, datë 27.10.2022, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kamëz, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor të Bulevardit Blu.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Kamëz, të marrë masa të menjëhershme për:
 - a. Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor të Bulevardit Blu, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
 - b. Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

¹ Subjekti ankues me e-mailin datë 25.08.2022, ka informuar se: “Fotot (e mungesës së aksesueshmërisë) janë realizuar në Bulevardin Blu, pranë sheshit kryesor ku ndodhet statuja e Nënë Terezës”.

3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Kamëz, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moshbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar, se Bashkia Kamëz ka marrë dijani për vendimin në datën 28.10.2022.

Me shkresën nr. 9966/1, datë 16.11.2022, Bashkia Kamëz ka informuar Komisionerin se: “Bashkia Kamëz jep dakordësinë për zbatimin e Vendimit nr. 197, datë 27.10.2022. Nga ana e Bashkisë Kamëz do të merren të gjitha masat e nevojshme në kuadër të plotësimit të standardeve për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Në vazhdimësi do planifikohen investime dhe rikonstruksione me qëllim për të eliminuar pengesat/barrierat dhe duke garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara”.

Në zbatim të vendimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 1121/7, datë 23.11.2022, ka kërkuar nga Bashkia Kamëz që brenda 7 ditëve nga marrja dijani për shkresën të dërgonte informacionin si më poshtë:

- Kopje e planit të masave për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.
- Kopje e planifikimit progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen e objekteve.
- Përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë së objekteve.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar nr. RR237998245AA, se Bashkia Kamëz ka marrë dijani për shkresën në datën 24.11.2022.

Bashkia Kamëz, pavarësisht faktit se ka marrë shkresën e sipërcituar, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri, në kuadër të zbatimit të vendimit.

Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 1121/8, datë 22.12.2022, ka kërkuar përsëri nga Bashkia Kamëz që brenda 7 ditëve nga marrja dijani për shkresën të dërgonte informacionin e kërkuar.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar nr. RR331179381AA, se Bashkia Kamëz ka marrë dijani për shkresën në datë 23.12.2022.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa”.

Bashkia Kamëz, si subjekt i cili është gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese nuk ka informuar dhe nuk ka zbatuar vendimin e Komisionerit. Në këtë mënyrë Bashkia Kamëz nuk ka përbushur

detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Kamëz, ky nen përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) personi juridik nga **60.000 deri në 600.000 lekë**;.....”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Kamëz është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, Bashkia Kamëz duhet të gjobitet me 100.000 (njëqind mijë) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, germet “b” dhe “d”, si dhe nenin 33/1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Bashkia Kamëz, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr. 197, datë 27.10.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr. 197, datë 27.10.2022, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA